# DËSHMI ARKIVI

**A-440794**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Spahiu shkarkon të besuarën e oligarkut që kopsiti letrat |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/13/rama-djeg-allajbeun-i-heq-tenderin-50-milione-euro-per-sterilizimin-ne-minutat-e-fundit-spahiu-shkarkon-te-besuaren-e-oligarkut-qe-kopsiti-letrat/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:05:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 07:39:55 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `24132e079af406e5ce9c06e517b82e09213ec8eab04c185e3e5412704e8aa02d` |
| TEKSTI | `c2fcd6c7137846b74d52b0abd4c9ac29421d23a6990526ad2487a21c2647f4a2` |
| PAMJA | `45e92138e1af0f9c96ba4646670330a82cc5b297a8ff11eed9d80f65f59b1178` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6b1d3ac64cb99c07598a2495d6051fc9a8dfcd2718c99f2ec767a838e13ef1b8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6b1d3ac64cb99c07598a2495d6051fc9a8dfcd2718c99f2ec767a838e13ef1b8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Spahiu shkarkon të besuarën e oligarkut që kopsiti letrat

Kryesore

Publikuar: 13/09/2026




Pas denoncimeve të njëpasnjëshme të VNA, ministrja e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu, ka vendosur të anulojë tenderin e Operatorit të Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit për ofrimin e shërbimit të hemodializës në pesë spitale rajonale, një procedurë prej afro 50 milionë eurosh ku e vetmja kompani në garë ishte "Diaverum AB".

Bashkë me tenderin, ndryshime kanë ndodhur edhe në drejtimin e OSHIS. VNA mëson se Arisa Cane është larguar nga posti i administratores, ndërsa në vend të saj është emëruar Yllka Sheta.

Kjo "shkundje", ende pa nisur mirë puna e OSHIS, vjen pas pikëpyetjeve të ngritura mbi mënyrën se si po shpërndaheshin kontratat e para të mëdha pas rikthimit të shërbimit nën administrimin e shtetit.

Vetëm pak ditë më parë, VNA zbuloi se OSHIS kishte shpallur fituese të tenderit për hemodializën kompaninë "Diaverum AB". Për procedurën me fond limit rreth 4.5 miliardë lekë ishte paraqitur vetëm një ofertues, ndërsa oferta e tij arrinte në rreth 4.44 miliardë lekë, afro 97% të shumës që shteti kishte parashikuar të shpenzonte.

VNA ngriti pikëpyetje jo vetëm për mungesën e konkurrencës, por edhe për lidhjet historike të fituesit me DiaVita-n, kompaninë e koncesionit të hemodializës, ku Spitali Amerikan i biznesmenit

Më të lexuarat


Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Spahi...


Benet Beci i dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administrat...


I tmerrshmi i Beratit / Si ra Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik kokaine, saga e ...


Pokelli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit izrae...


Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Klodian Allajbeu kishte qenë aksioner.

Tashmë, kontrata që dukej se po shkonte drejt firmosjes është ndalur.

Anulimi përmbys procedurën që do t'i siguronte Diaverum një kontratë tjetër 4-vjeçare prej dhjetëra milionë eurosh dhe e detyron OSHIS të rihapë çështjen e mënyrës se si do të sigurohet shërbimi i hemodializës në pesë spitalet rajonale.

Por lëvizja bëhet edhe më domethënëse nga ndryshimi në krye të vetë institucionit.

Arisa Cane ishte emëruar administratore e OSHIS në janar 2026, me mandat deri në vitin 2029. Vetëm disa muaj më vonë, mandati i saj është ndërprerë dhe drejtimi i është besuar Yllka Shetës.

VNA kishte raportuar më herët se përpara marrjes së drejtimit të OSHIS, Cane kishte punuar për disa vite në Spitalin Amerikan të Klodian Allajbeut. Ky fakt, i kombinuar me tenderin ku "Diaverum" u shpall fituese përmes një procedure urgjente dhe pa asnjë garë, shtoi pikëpyetjet për një "kostum të qepur me porosi" dhe dyshimet për lidhjet mes Canes dhe Allajbeut.

Po aq e rëndësishme është ajo që vjen më pas. Hemodializa është një shërbim jetik që nuk mund të ndërpritet, ndaj OSHIS dhe Ministria e Shëndetësisë duhet të përcaktojnë tashmë se si do të procedohet me kontraktimin e tij.

Për e sigurt është që Rama ia ka fikur dritën jeshile kontratës që po shkonte drejt Diaverum, duke e lënë Allajbeun pa "çekun" 50-milionë eurosh dhe pa "marionetën" e tij në krye të OSHIS.

Por jo aq optimist është edhe administratorja e re që do drejtojë kompaninë shtetërore. Yllka Sheta është një emër tjetër anonim pa ndonjë eksperiencë për të menaxhar fonde kaq të mëdha.

**/VNA**

TAG: djeg allajbeun | Rama | Sterilizimi | tenderi 50 mln euro

## Të ngjashme



**Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së**



**Pacolli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për**



**Benet Beci i dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë**

**akoma gjallë brenda saj**

**t'ia dhënë biznesmenit izraelit Kon Yeffet**

**të birin. Postet në administratë të djalit të kryebashkiakut të Shkodrës, si i pa...**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë



Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.